



REPUBLIKA E SHQIPËRISË




GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN



Planit Strategjik i Komunikimit

Miraturar me Vendimin nr. 590 datë 26.11.2020 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor





Realizimi i Planit Strategjik të Komunikimit Miratuar me Vendimin nr. 590 datë 26.11.2020 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

Hyrje

Në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, miratuar me **Vendimin Nr. 590 datë 26.11.2020**, i cili synon përcaktimin e bazave për përmirësimin e marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun, të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, në zbatimit të Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, në zbatim të nenit 91 të tij, i cili parashikon qasjen në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun dhe zbatimit të Ligj nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i cili ngarkon gjykatat me detyrime specifike për të ndërtuar dhe garantuar transparencë mbi veprimtarinë e tyre për palët në proces, grupet e interesit, publikun dhe median, si edhe me qëllim rritjen e transparencës së punës së Gjykatave, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nisi zbatimin e Planit të Veprimit në **Vitin 2023** dhe gjatë kësaj periudhe kalendarike, në zbatim të objektivave të përcaktuara në këtë plan synuam të arrinim përmirësimin e nivelit të besimit të medias dhe të gjithë aktorëve të jashtëm ndaj Gjykatës, nëpërmjet krijimit të lehtësisë të procedurave për aksesimin dhe marrjen e informacionit në mënyrë eficiente, në kohë të shpejtë dhe në çdo rast brenda afateve ligjore duke përdorur mekanizma, mjete dhe mënyra inovatore të komunikimit dhe informimit të Gjykatës drejt medias, publikut, institucioneve, palëve ndërgjyqëse dhe grupeve të interesit.

Duke konsideruar faktin se, *hartimi i këtij plani është udhëhequr nga standardet dhe parimet ndërkombëtare duke reflektuar praktikat më të mira të krijuara nga zbatimi i modeleve ekzistuese të planeve të komunikimit të gjykatave në rajon, nivel evropian e më gjerë*, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan gjatë periudhës kalendarike 2023-2024 është përpjekur të realizojë objektivat e përcaktuara në këtë plan me përkushtim dhe me seriozitet maksimal, duke i kushtuar një vëmendje dhe angazhim maksimal vendosjes së raporteve transparente dhe profesionale me median në vlerësim të faktit se, **gjeneza e medias ka lindur pikërisht si kërkesë e publikut për të mësuar mbi dhe për pushtetin, si e tillë, është jo vetëm një strukturë informuese për dhe mbi pushtetin, por edhe një strukturë plotësuese e kërkesave të publikut për të kontrolluar pushtetin.**

Si kërkesë e ligjit për të Drejtën e Informimit dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, si edhe si pjesë e objektivave të Planit Strategjik të Komunikimit, jemi treguar rigoroz në trajtimin e **kërkesë/ankesave** të publikut që vijnë në adresë të postës elektronike dhe jo vetëm, nga palët në proces gjyqësor, publiku dhe mediat, duke zbatuar në mënyrë rigoroz legjislacionin në fuqi për të vlerësuar interesin e ligjshëm të palëve për marrjen e informacionit dhe për të mundësuar komunikimin e informacionit brenda afateve ligjore.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit gjatë ushtrimit të funksionit për të Drejtën e Informimit, i cili lidhet në mënyrë organike me zbatimin e ligjeve, kodeve, dispozitave ligjore në fuqi, si dhe udhëzimeve të hartuara në përputhje me funksionin e Marrëdhënieve Publike dhe Medias për Gjyqësorin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si edhe në lidhje me detyrimin parësor që lidh Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median për informimin e publikut, për të ruajtur balancim korrekt ndërmjet raportit të dhënies dhe kufizimit të informacionit ka mbajtur në konsideratë dhe ka zbatuar legjislacionin, udhëzimet dhe dispozitat ligjore si në vijim:

-Neni 23 të Kushtetutës së Shqipërisë i cili sanksionon të Drejtën për informim, si një ndër të drejtat themelore të individit, përcaktohet se: **"1. E Drejta për Informim është e garantuar; 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacione për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore; 3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive. Përmes përcaktimit të saj si një e drejtë kushtetuese, garantohet respektimi i një të drejte themelore për sistemin e organizimit politik e institucional të shtetit ligjor."**

-Neni 279/3/b. i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë : **"Detyrimi për të Ruajtur Sekretin Hetimor" i cili përcakton në pikën 3.b "Ndalimin e publikimit të përmbajtjes së akteve të veçanta apo të dhënave të posaçme që lidhen me veprime hetimore".**

-Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999, **"Për të Drejtën e Informimit për Dokumente Zyrtare"**, Në të cilin njihet e drejta e informimit të çdo qytetari për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Sipas këtij ligji, të drejtën për të kërkuar informacion për dokumentet zyrtare e ka çdo shtetas shqiptar, i huaj, person pa shtetësi, si dhe personat juridikë. Neni 3/1 i ligjit të sipërpërmendur përcakton edhe format në të cilat mund të kërkohej informacioni: **"me gojë ose me shkrim, pa qenë e nevojshme të jepen shpjegime për arsyet ose motivet e kërkesës, ose dokumentacion shoqërues. Çdo qytetar mund të marrë informacionin e kërkuar me shkrim, me gojë, postë elektronike etj."**

Nisur nga nocioni i interesit publik, çdo kërkesë është trajtuar duke vlerësuar dhe balancuar **ekuilibrin mes përfitimit dhe humbjes** së mundshme që mund t'i shkaktohet **interesit publik** nga lejimi ose nga kufizimi i së drejtës së publikut për t'u informuar, pasi që si çdo e drejtë, dhe e drejta për informim ka detyrimet dhe kufizimet që duhen trajtuar me kujdes dhe përgjegjshmëri të veçantë për çdo kërkesë për informacion, ku prevalon interesi më i lartë publik. Nën detyrimin e parimit të **trajtimit të kujdesshëm të çdo kërkesë/ankese për informacion publik dhe mediatik** i referohemi, konsultohemi dhe zbatojmë me përpikmëri legjislacionin poshtëvijues:

- Ligj Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit";
- Ligj Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"; shfquizuar me Ligj 124/2025 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale";
- Ligj nr. 98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 "Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median";
- Ligjin Nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligj Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë";
- Ligj Nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror" (Ndryshuar me ligjin nr.9541, datë 22.5.2006) (Ndryshuar me ligjin 25/2012);
- Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;
- Si edhe çdo ligji tjetër në fuqi, udhëzime dhe urdhëra për zbatim të Këshillit të Lartë Gjyqësor në funksion të mirëadministrimit të sektorit të marrëdhënieve të publikut dhe medias me gjykatat.

Funksioni primar i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, është komunikimi dhe informimi i saktë, i qartë dhe i kuptueshëm, duke mos cënuar interesin publik. *Objektiv kryesor* gjatë zbatimit të Planit Strategjik të Komunikimit ka qenë *krystalizimi dhe lartësimi i opinionit dhe qëndrimit të publikut ndaj Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan*, duke përdorur mekanizmat e nevojshëm dhe të duhur inovator për arritjen e një komunikimi të shpejtë dhe të saktë, në përgjigje të kërkesave dhe informimit të publikut për çështje me karakter të publik, si edhe kërkesave me karakter të posaçëm për çështjet që rezultojnë me status në përpunim.

Në kuadër të afrimit të grupeve të interesit me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, gjatë kësaj periudhe të ushtrimit të funksionit dhe vendosjes në zbatim të Planit Strategjik të Komunikimit **për periudhën kalendarike 2023-2024, jemi kujdesur të konceptojmë, organizojmë dhe përshtasim aktivitete me tematika të përcaktuara në objektivat e Planit të Veprimit**, me qëllim informimin dhe afrimin e publikut, institucionet, mediat dhe grupet e interesit me veprimtarinë e gjykatës, aktivitete të cilat janë dokumentuar në rrjete sociale, faqen zyrtare të Gjykatës dhe nëpërmjet Revistave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Organizimi i aktiviteteve të vazhdueshme është realizuar në përputhje me tematikat e përcaktuara në Planin Strategjik të Komunikimit, duke promovuar kështu një vullnet të mirë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për afrimin e target grupeve të synuara, lehtësimin e aksesit në Gjykatë dhe veprimtarinë e saj nga grupe interesi të caktuara duke rritur kështu nivelin e besimit në publik.

Duke konsideruar faktor të rëndësishëm faktin që Nëpunësi për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median, duhet të komunikojë në mënyrë efektive me publikun dhe me median, jemi përpjekur në mënyrë të vazhdueshme të ruajmë një komunikim korrekt me grupet e interesit, publikun dhe mediat duke dhënë informacionin në përputhje me një vlefësim paraprak të ligjshmërisë së tyre për t'u informuar dhe duke ju përmbajtur qëllimit dhe përgjegjësisë të funksionit të Koordinatorit të Drejtës së Informimit, me operimin e **kthim-përgjigjeve brenda afateve që parashikon ligji për kërkesë/ankesat**.

Në kuadër të plotësimit të kërkesave të Planit Strategjik të Komunikimit, i cili është një plan me bazë objektivash, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nëpërmjet Koordinatorit për të Drejtën e informimit ka kryer në mënyrë të vazhdueshme përditësime në faqen zyrtare, këndet e informimit në Gjykatë dhe llogaritë e rrejteve sociale me informacione të vazhdueshme në formë broshurash informuese ose video informuese, deklaratah për shtyp, publikime vendimesh me interese të lartë publik etj., nën kujdesin e vazhdueshëm të përzgjedhjes së materialeve, formave të trasmetimit dhe përzgjedhjes së tematikave nga Gjyqtari i Medias dhe Zv/ Kryetarët e Gjykatës.

Një ndihmesë e veçantë për realizimin e një komunikimi profesional është referenca e vazhdueshme në objektivat e caktuara në Planin e Veprimit të "Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor", i miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për elaborimin dhe sofistikimin e një ndikimi pozitiv, të vazhdueshëm dhe profesional në drejtim të rritjes së transparencës, nivelit të informimit, cilësisë së shërbimeve, profesionalizmit dhe për rrjedhojë rritjes së besimit të publikut në sistemin gjyqësor, pasi që në të gjejmë të përcaktuara përparësitë e komunikimit, objektivat, grupet e synuara, mesazhet kryesore që duhet të përcillen, si edhe mjetet e nevojshme të komunikimit, i cili gjithashtu orjenton dhe sygjeron mbi zgjidhjet novatore dhe qasjet më të mira për të komunikuar në mënyrë efektive duke shfrytëzuar të gjithë mjetet e komunikimit që mundëson teknologjia dhe burimet njerëzore.

Në funksion të komunikimit dhe përmbushjes së kërkesave për realizimin të objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik të Komunikimit, me kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor për raportim të planit të veprimit, kemi hartuar dhe raportuar vazhdimisht në mënyrë periodike mbi realizimin e objektivave të këtij Planit Veprimi, sipas formatit të përcaktuar të raportimit, shtojcë e Planit të Komunikimit për informim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për plotësimin e objektivave nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Është krijuar tradita e ndërveprimit me korrespondencë elektronike të përditëshme nga media, publiku, palët ndërgjyqëse, avokatët, institucione etj., të cilët ndërveprojnë nëpërmjet këtij mjeti për depozitimin e shpejtë: **të kërkesave për shtyrje seancash gjyqësore, për depozitim aktesh për seancat gjyqësore, për kërkesat për përshpejtim të seancave gjyqësore, kërkesa për informacion mbi statusin e çështjeve në shqyrtim nga palët ndërgjyqëse, për informacione me karakter publik, kërkesat e medias mbi raporte e statistika sipas objektit të përcaktuar prej tyre, si edhe ndërveprimi me institucionet për njoftimet e seancave gjyqësore në lidhje me: kërkesat për shoqërim të dërguara në dhe nga Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Komisaritet e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, por edhe më gjërë. korrespondencë e njoftimeve për seancat gjyqësore për Zyrat e Shërbimeve Sociale të Bashkive të Rrethit Elbasan, Institutin e Mjekësisë Ligjore, si edhe dërgimi i fletët-thirrjeve palëve ndërgjyqëse nëpërmjet postës elektronike zyrtare të Gjykatës, korrespondenca e mbajtur me Ambasadat etj.**

Është krijuar tradita e informimit nëpërmjet njoftimeve publike për mungesën e gjyqtarëve në ditë të caktuara, në mënyrë që të evitohet pritja dhe të informohen palët ndërgjyqëse për moszhvillimin e seancave gjyqësore në kohë reale, për një komunikim sa më të shpejtë dhe transparent.

Me qëllim promovimin dhe transparencën e informimit të publikut janë publikuar njoftime në lidhje me procesin e rishoritimeve dhe formularëve që lehtësojnë aksesin dhe procedurat e palëve të interesit në gjykatë, të cilat janë njoftuar në këndet e informimit të dedikuara në ambientet e Gjykatës, në faqen zyrtare në rubrikën Njoftime për Publikun, si edhe në rrjetet sociale.

Me synim identifikimin, promovimin, informimin dhe rritjen e transparencës së sistemit gjyqësor, forcimim e bashkëveprimit të Gjykatës me institucione arsimore dhe grupe interesi, si edhe afrimin e komunitetit me Gjykatën, është publikuar në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare njoftimi me anë të cilit Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, shpreh interesin gadishmërinë dhe mbështetjen e saj për organizimin e aktiviteteve publike me natyrë edukative dhe informuese për të gjithë palët e interesuara të cilat mund të aplikojnë paraprakisht nëpërmjet paraqitjes së një kërkesë në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, manjola.kume@gjykata.gov.al. Në këtë njoftim gjende të përcaktuara kushtet e përgjithshme të ndërtimit të kërkesës, e cila duhet të përmbajë të dhënat e subjektit të interesuar, tematikën e aktivitetit për të cilin shprehin interes dhe të dhënat e kontaktit, në mënyrë që të kontaktohen nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median për ndërtimin e agjendës pas miratimit të kërkesës nga drejtuesit e Gjykatës.

Përditësimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me publikimin e listave të çështjeve të gjykimit, shpalljeve publike, lajmërimeve përmes afishimit, njoftimeve për shtyp, publikimin e materialeve me informacion juridik mbi të drejtat e njeriut etj, duke ndihmuar kështu grupet e interesit për të patur një akses më të lehtë dhe më të thjeshtë në marrjen e informacionit për të cilin kanë interes.

Matja e numrit të shikimeve, pëlqimeve, shpërndarjeve, komenteve të materialeve të publikuara monitorohet vazhdimisht nëpërmjet opsioneve të menaxhimit që vetë platformat e rrjeteve sociale ofrojnë dhe rezultojnë se numrin më të lartë dhe aktiv të ndjekësve e kemi në adresat tona në Facebook i cili rezultojnë me një rritje të numrit të ndjekësve i ndjekësve të para dy vitetve nga afërsisht 390 (treqind e nenetdhjetë) ndjekës, aktualisht janë shtuar afërsisht mbi 1700 (njëmijë e shtatëqind) ndjekës në rrjetin social facebook.

Në funksion të transparencës dhe me qëllim lehtësimin e procedurës së marrjes së informacionit nga palët e interesit për kalendarin e çështjeve të seancave gjyqësore të javës publikohen listat e gjyqimeve të përditësuara çdo javë në faqen zyrtare në rubrikën Njoftime sipas relatorëve të çështjeve, lidhje e cila i njoftohet çdo të premte publikut në rrjetin social facebook për aksesim të drejtëpërdrejtë, si edhe njihjen dhe promovimin tek publiku me faqen zyrtare të gjykatave www.gjykata.gov.al si kërkesë e planit.

Në kuadër të transparencës për vitin 2023-2024, regjistri i kërkesave është plotësuar dhe publikuar në përputhje me formatin e përcaktuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Në këtë regjistrë nuk publikohen kërkesat e depozituara në postën elektronike zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan që lidhen me kërkesat për informacion të palëve mbi çështjet në gjykim të cilat rezultojnë në përpunim si psh (kërkesa për shortin, për planifikime seancash, kërkesa shtyrje, parashtrime, kërkesa drejtuar gjyqtarëve për çështjet në gjykim dhe përpunim etj) si edhe kërkesa të depozituar në Arkivin e Gjykatës për (dosje, akte dosjesh, vendime etj).

Totali i kërkesave të trajtuara për Vitin 2023 të paraqitura nëpërmjet postës elektronike zyrtare të Gjykatës është 575 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) kërkesa. **Në këtë të dhënë është përjashtuar korrespondenca e mbajtur me:** institucionet, korrespondenca e institucioneve për depozitim dokumentacioni për seancat gjyqësore, si depozitim dokumentacioneve të përcjellë nga: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Komisaritet e Policisë, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Ambasadat etj., dhe janë përfshirë në këtë të dhënë (kërkesa për informacion nga palët ndërgjyqëse, përfaqësuesit ligjorë, mediat, publiku për: informacion mbi shortin; informacion për planifikime seancash gjyqësore, informacion me karakter publik, kërkesa të palëve ndërgjyqëse për shtyrje seancash gjyqësore, depozitime parashtrimesh, kërkesa drejtuar gjyqtarëve për çështjet në përpunim, kërkesa për pushim çështjes gjyqësore, kërkesa për statusin e gjykimit, kërkesa për vendime gjyqësore, ankesa të palëve ndërgjyqëse, kërkesa për mospjesëmarrje në seancë gjyqësore, kërkesa për përshpejtim etj.) ndër to, janë publikuar 35 (tridhjetë e pesë) kërkesa me karakter publik e cilat janë afishuar në regjistrin e kërkesave të publikuara sipas formatit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Totali i kërkesave të trajtuara për Vitin 2024 të paraqitura nëpërmjet postës elektronike zyrtare të Gjykatës është 948 (nëntëqind e dyzet e tetë) kërkesa. **Në këtë të dhënë është përjashtuar korrespondenca e mbajtur me:** institucionet, korrespondenca e institucioneve për depozitim dokumentacioni për seancat gjyqësore si dokumentacioni i përcjellë nga: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Komisaritet e Policisë, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Ambasadat etj., dhe janë përfshirë në këtë të dhënë (kërkesa nga palët ndërgjyqëse, përfaqësuesit ligjorë, mediat, publiku për: informacion mbi shortin; informacion për planifikime seancash gjyqësore, informacion me karakter publik, kërkesa të palëve ndërgjyqëse për shtyrje seancash gjyqësore, depozitime parashtrimesh, kërkesa drejtuar gjyqtarëve për çështjet në përpunim, kërkesa për pushim çështjes gjyqësore, kërkesa për statusin e gjykimit, kërkesa për vendime gjyqësore, ankesa të palëve ndërgjyqëse, kërkesa për mospjesëmarrje në seancë gjyqësore, kërkesa për përshpejtim etj), ndër to janë publikuar 79 (shtatëdhjetë e nëntë) kërkesa me karakter publik, të cilat janë afishuar në regjistrin e kërkesave të publikuara sipas formatit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Në kuadër të plotësimit të kërkesave të Ligj nr.9877, datë 18.02.2008 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", neni 18, si dhe në mbështetje të nenit 4 të Ligj Nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit" dhe Urdhërit Nr.14 dt.22.01.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjes e të Dhënave Personale, në vitin 2023 u konceptuan materialet dhe **u hartua** nga Koordinatorin për të Drejtën e Informimit **Programi i Transparencës**, i cili u publikua në fillim të **Vitit 2024**, në funksion të transparencës, orientimit dhe informimit të publikut. Programi gjendet i publikuar në faqen zyrtare dhe është në përditësim të vazhdueshëm në përshtatje sipas ndryshimeve të herëpashershme. Pas miratimit të tij u vendosën në dispozicion kopjet e materialit në sektorët përkatës për zbatim, të përcaktuara dhe pasqyryra edhe në përmbajtjen e Programit të Transparencës. E

Janë realizuar video me përmbajtje informuese ligjore në përputhje me tematikat e përcaktuara në Planin Strategjik të Komunikimit.

Janë realizuar publikime informacionesh që kanë tërhequr interesin e medias për depozitim të kërkesave për realizim të intervistave mediatike, të cilat janë trasmetuar në Televizione Kombëtare me impakt të lartë publik për të promovuar punën e Gjykatës, cilësojmë intervistat e dhëna për: Top Media, Radio Televizioni Shqiptar, Abc News, Gazeta BIRN. Jemi kujdesur të organizojmë takime dhe aktivitete me qëllim ndërveprim institucional me grupe interesi. Nga takimet ndërinstitutionale janë arritur marrëveshje bashkëpunimi të rëndësishme në funksion të proceseve gjyqësore dhe mbarëvajtjes së punës.

Theksojmë se, synimi ynë gjatë këtij rrugëtimi të mbushur me sfida ishte rritja e besimit të publikut, medias dhe të gjithë aktorëve të jashtëm, udhëhequr nga parime të posaçme si paanshmëria; integriteti individual, institucional dhe profesional; barazia; trajtimi i drejtë, besueshmëria dhe ruajtja e konfidencialitetit; respekti për bashkëpunëtorët në këtë proces, për palët e interesit, nëpunësit dhe çdo individ i mjedisit të jashtëm që lidhet me gjykatën; përgjegjshmëria e lartë për ushtrimin e funksionit; transparencja; sjellja e hijshme, vetëpërmbytja në situata kritike dhe të tensionuara, të cilat të ndërthurura së bashku kontribuojnë në ruajtjen dhe ndërtimin e ekuilibrave të shëndetshëm për mos çënuar dhe për të forcuar besimin e mjedisit të jashtëm dhe integritetin e institucionit tonë.

Për realizimin e objektivave janë ndërmarrë hapa konkretë për mirëinformimin transparent dhe janë përdorur mekanizma, mjete dhe mënyra inovatore të komunikimit dhe informimit midis Gjykatës me median dhe publikun, për rritjen dhe përmirësimin e performacës së institucionit, si edhe rritjen e vlerësimit nga ambienti i jashtëm për ambientin e brendshëm të saj.

Në kuadër të zbatimit të këtyre objektivave të përcaktuara për arritje nga Planit Strategjik i Komunikimit si: **“Objektivi nr.1, i cili parashtrohet nevojën për informimin e publikut dhe promovimi i rezultateve të arritura deri më sot për sistemin gjyqësor nga zbatimi i “Reformës në Drejtësi”, objektivi nr. 2, i cili synon: identifikimin, promovimin, informimin dhe rritjen e transparencës së sistemit gjyqësor nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit, si mjet novator i komunikimit në mënyrë efikase dhe të shpejtë, mes grupeve të interesit dhe gjykatave dhe të përshtatjes së formës tradicionale të komunikimit të gjykatave me teknologjinë e re, për t’iu përgjigjur kërkesave të publikut dhe nevojave të tyre për një komunikim interaktiv, të shpejtë, efikas dhe cilësor, objektivi nr.3, i cili synon informimin e publikut me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, mbi funksionet, veprimtarinë e gjykatave dhe mënyrën se si mund t’i drejtohen gjykatës, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ka ndërmarrë këto hapa zbatimi, objektivi nr.4, i cili synon informimin e publikut, veçanërisht të grupeve në nevojë dhe të miturve, lidhur me ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe tarifat gjyqësore, objektivi Nr:5 i cili synon përformimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet gjykatave dhe medias, OSHC-ve, palëve të tjera të interesit, objektivi nr: 6, i cili ka për synim afrimin e komunitetit me Gjykatat përmes organizimit të aktiviteteve publike dhe fushatave ndërgjegjëse”,** Koordinator i të Drejtës së Informimit të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka realizuar një sërë broshurash, dhe video informuese në lidhje me tematikat e caktuara, ka organizuar një sërë aktiviteteve dhe bashkëpunimesh në kuadër të afërimit të komunitetit dhe promovimit të punës të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të gjykatës www.gjykata.gov.al, ndër të cilat përmendim si në vijim:

Materiale Informuese

Janë hartuar dhe publikuar **55 materiale informuese** të cilat, më pas, janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në rubrikën “Njoftime për publikun” ose “Pasqyra e Shtypit”, si edhe në rrjetet e saj sociale për të informuar grupet e interesit. Këto materiale informuese janë përshtatur me tematikat e përcaktuara në Planin Strategjik të Komunikimit dhe referojnë informacion në lidhje me Organizimin e Pushtetit Gjyqësor, kompetencat e Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, shërbimet e ofruara gjykata, tarifat gjyqësore, materiale informuese në lidhje me përfitimimin e Ndihmës Juridike të Garantuar nga Shteti, plotësimin e formularit FEA. Mënyrat si palët mund t’i drejtohen gjykatës për një kërkesë- padi civile apo penale, materiale informuese mbi Instrumentet Ligjorë Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, materiale informuese mbi mënyrat e kërkimit të informacion mbi shorin, kalendarin e seancave gjyqësore, trashëgimnë kulturore, të drejtat e fëmijëve, të Miturit në Konflikt me Ligjin, të drejtat e personave me Aftësi të Kufizuar etj të renditura në vijim:

- Krijimi i logos së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në kuadër të festimit të 110 vjetorit të aktit të parë juridik “Kanoni i Zhurisë” i shpallur nga qeveria e Ismail Qemalit, më datë 10.05.1913, si akti i parë juridik që hodhi themelet e organizimit të pushtetit gjyqësor në shtetin e pavarur shqiptar;
- Fletë-palosje informuese për zyrat e shërbimit për Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të përgatitura nga KLGJ;
- Fletë-palosje informuese “Organizimi i Pushtetit Gjyqësor”;
- Fletë-palosje informuese për “Kompetencat tokësore të Gjykatës së Shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan”;
- Fletë-palosje informuese për “Të dhënat statistikore, për vitin 2022, për numrin e çështjeve me objekt nenin 130/a. ``Dhuna në familje`` dhe ``Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtje``”, “Statistikat neni 130/ a “Dhuna në Familje”, viti 2022” dhe “Statistikat për ligj nr.9669, neni 10”;
- Fletë-palosje informuese për mënyrën se “Si ti drejtohem gjykatës me një kërkesëpadi”;
- Fletë-palosje informuese për “Shërbimet që ofrojnë Gjykatat”, të përgatitura nga KLGJ;
- Fletë-palosje informuese për “Përfashtimi nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Kush dhe si mund ti përfitojë ato?”;
- Fletë-palosje informuese për “Ndihma juridike e garantuar nga shteti si një e drejtë themelore”;
- Fletë-palosjeinformuese për “Tarifat në lekë për veprime e shërbime që kryhen nga administrata Gjyqësore e Prokuroria”;
- Fletë-palosje informuese për “Rregulla të përgjithshme sjelljeje brenda ambienteve të Gjykatës”;
- Fletë-palosje informuese për “Si të hapni një çështje civile”;
- Fletë-palosje informuese për “Mënyra e paraqitjes së kërkesave të palëve të interesuara për mënyrën e depozitimit të tyre në postë”;
- Fletëpalosje informuese për “Plotësimi i FEA-s (Formular Elektronik Aplikimi)”;
- Fletëpalosje informuese për mënyrën e kërkimit të “Informacion mbi Shorin”;
- Fletë-palosje informuese për “Kalendarit të seancave gjyqësore”;
- Fletë-palosje informuese për, “Ligj. 18/2017 ``Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Fletë-palosje informuese për “Personat me aftësitë kufizuar dhe ligj nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- Fletë-palosje informuese për “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”;
- Fletë-palosje informuese për “Ndërmjetësimi, forma e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve pa gjykatë”;
- Fletë-palosje informuese për “Informim për ankimi, rekursi, kërkesa për rishikim”;
- Fletë-palosje informuese për “Trashëgimia kulturore juridike e Republikës së Shqipërisë”; mbi vlerën kulturore juridike të datës 10 maj1913 “Dita Kombëtare e Drejtësisë”, në Republikën e Shqipërisë;
- Fletë-palosje informuese për “Kërkesë-padi standarte ose 1 % mbi vlerën e saj”;
- Fletë-palosje informuese “Poster promovues për datën 10 maj 1913”;
- Fletë-palosje informuese për “Të Drejtat Civile Dhe Politike , përkthimi i Letrës së Martin Luther King Jr. “Letër Nga Burgu i Birminghamit”;
- Fletë-palosje informuese për “Procesi Gjyqësor Civil”;
- Fletë-palosje informuese për “Procesi Gjyqësor Penal”;
- Fletë-palosje informuese për “Trashëgimia kulturore juridike e Republikës së Shqipërisë”; mbi vlerën kulturore juridike të datës 10 maj1913 “Dita Kombëtare e Drejtësisë”, në Republikën e Shqipërisë;
- Fletë-palosje informuese për “Kërkesë-padi standarte ose 1 % mbi vlerën e saj”;
- Fletë-palosje informuese “Poster promovues për datën 10 maj 1913”;
- Fletë-palosje informuese për “Të Drejtat Civile Dhe Politike , përkthimi i Letrës së Martin Luther King Jr. “Letër Nga Burgu i Birminghamit”;
- Fletë-palosje informuese për “Procesi Gjyqësor Civil”;
- Fletë-palosje informuese për “Instrumentet Ligjorë Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (II)”, në përmbytje të tij gjendet informacion për “Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut” (1948);
- Fletë-palosje informuese për “Instrumentet Ligjorë Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (III)”, në përmbytje të tij gjendet informacion për “Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Shoqërore dhe Kulturore”;
- Fletë-palosje informuese për “Instrumentet Ligjorë Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (IV)”, në përmbytje të tij gjendet informacion për “Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave” (1979);
- Publikimi i 18 (tetëmbëdhjetë) eseve të krijuara nga nxënës të shkollave të mesme publike dhe private me titull “Të drejtat e fëmijëve”;
- Fletë-palosje informuese për “Instrumentet Ligjorë Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (I)”, në përmbytje të tij gjendet informacion për “Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut” (1948);
- Fletë-palosje informuese për “Instrumentet Ligjorë Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (II)”, në përmbytje të tij gjendet informacion për “Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Shoqërore dhe Kulturore”;
- Fletë-palosje informuese për “Instrumentet Ligjorë Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (III)”, në përmbytje të tij gjendet informacion për “Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave” (1979);
- Fletë-palosje informuese për “Instrumentet Ligjorë Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (IV)”;
- Fletë-palosje informuese për “Instrumentet Ligjorë Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (V)”, në përmbytje të tij gjendet informacion për “Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar” (2006);
- Fletë-palosje informuese për “Mënyra e drejtimit të një kërkesë në gjykatë”;

- Fletë-palosje informuese për "Informacion mbi Shortin";
- Fletë-palosje informuese për "Ogranizimin e Zyrave dhe Funksioneve të Administratës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionin e Përgjithshëm Elbasan";
- Fletë-palosje informuese për "Lajmërimet përmes afishimit nga Zyrat e Përbmarimit";
- Fletë-palosje informuese për "I Mituri në Konflikt me Ligjin", referon informacion në lidhje me Ligj Nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur";
- Fletë-palosje informuese për "Tarifat Gjyqësore", në përmbajtje të tij informacion mbi kuadrin ligjor të përcaktimit të tarifave gjyqësore bazuar në Ligj 98/2017 "Për Tarifat Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë";
- Hartimi dhe përpunimi i të dhënave të kërkesave të medias në lidhje me, përpunimi i të dhënave në lidhje me "Të dënuarit të mitur, masat e dënimit për të mitur dhe baza ligjore për shkeljet e të miturve në konflikt me ligjin për vitin 2022 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan";
- Fletë-palosje informuese për "Instrumentet Ligjorë Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (VI)", gjendet informacion mbi kuadrin ligjor të garantimit të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri, garantimi i të drejtave për punësimin e personave me aftësi të kufizuar parashikuar në Ligj 7995 dt 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit", garantimi i të drejtave për sigurim shëndetësor për personat me aftësi të kufizuar, parashikuar me Ligj 7880 dt 13.10.1994 "Për sigurimin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", garantimi i të drejtave për aftësinë e kufizuar parashikuar në Ligj 8092, dt 21.03.1996 "Për shëndetin mendor për personat me aftësi të kufizuar", garantimi i të drejtës për arsim për personat me aftësi të kufizuar parashikuar në ligj 8872 dt 29.03.2002 "Për arsimin profesional në Republikën e Shqipërisë" etj.;
- Material informues "Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave Me Publikun Dhe Median";
- Fletë-palosje informuese për "Koncepti i të Drejtave të Njeriut", referuar Nenit 27 i (Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike): dhe teksteve të mirënjohura të: Luan Omari, Aurela Anastasi – E drejta kushtetuese; Luan Omari- Shteti i së drejtës; Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), 3 shtator 1953. Kristaq Kraja- Kushtetuta dhe sistemi i mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut, Konferencën e OKB-së 1993 në Vjenë mbi të Drejtat e Njeriut etj. Materiale të cilat i vijnë në ndihmë nxënësve dhe palëve të tjera të interesit për informacion të përgjithshëm mbi këto të drejta;
- Fletë-palosje informuese në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, 8 Mars u publikua artikulli me të njëjtin titull në kujtesë të simbolikës së kësaj dite dhe në nderim të figurave të rëndësishme të grave Shqiptare dhe grave Shqiptare në Drejtësi në shenjë falenderimi për kontributin e tyre në shoqëri, si edhe mirënjohje për punën e të gjithë Trupës Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si edhe punës së vazhdeve e grave të administratës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të cilat janë një mekanizëm i domosdoshëm për ecurinë dhe mbarrëvajtjen e punës në Gjykatë;
- Fletë-palosje informuese për Statistika për të Dënuar të Mitur, vitet 2022-2023. Ky artikull tërhoqi vëmendjen e medias e cila u drejtua me kërkesë për realizimin e një interviste në lidhje me këtë objekt;
- Në kuadër të aktivitetëve për Javën e Drejtësisë në datë 10 dhe 17 maj 2024 u publikuan 47 (dyzet e shtatë) esetë e nxënësve të shkollave të mesme të qytetit të Elbasanit me tematikë shkrimi i një eseje me temë "Inkluzioni dhe të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar". Ky aktivitet, i konceptuar në zbatim të objektivave të përcaktuara në "Planin Strategjik të Komunikimit", në kuadër të "Javës së Drejtësisë" ka për qëllim njohjen, zhvillimin e njohurive, si edhe integrimin e të rinjve në fushën e së drejtës dhe në Vitin 2024 pjesëmarrja dhe interesi i institucioneve por edhe i vetë nxënësve për pjesëmarrje ishte më i lartë;
- Fletë-palosje informuese e nishtë së Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë, në kuadër të zbatimit të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), publikimin e informacionit për hapjen e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore për kategoritë e veçanta dhe individët në nevojë, në Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, duke shpjeguar dhe afishuar fletëpalosje informuese mbi: - Shërbimin ligjor falas për kategori më të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme si dhe kategori të veçanta. - Shërbimet që mund të përfitonin pranë kësaj qendre - Individët që e përfitojnë ndihmë ligjore falas pranë kësaj qendre - Kategoritë që e përfitojnë shërbim ligjor falas pranë kësaj qendre - Informacion mbi të dhënat e kontaktit për Ndihmën Juridike Falas në Elbasan;
- Njoftim Publik në kuadër të miratimit të "Strategjisë Kombëtare të Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata (2024-2027)" Maj 2024, Zv/ Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga, mori hapa konkretë në mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, datë 15.10.2024 me Vendimin nr. 1796 prot., datë 21.10.2024 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan vendosi: "(...) 2. Kategorizimi dhe inventarizimi i çështjeve gjyqësore të prapambetura dhe marrja e masave në vijim me qëllim uljen e numrit të çështjeve gjyqësore të prapambetura (...)", për analizimin dhe përcaktimin e një metodologjie objektive për të kategorizuar dhe inventarizuar listat e grupçështjeve të prapambetura që do të vendosen në lëvizje me procedura të përpjekjuara. Në zbatim të objektivit Nr. 7, të "Strategjisë Kombëtare të Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata (2024-2027)" e cila përcakton Rritjen e transparencës dhe forcimi i besimit të publikut në sistemin gjyqësor, u krye informim publik për palët në proceset gjyqësore, avokatët dhe për publikun për marrjen e masave për uljen e numrit të çështjeve gjyqësore të pashqyrtuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
- Në kuadër të mirëinformimit të publikut është krijuar tradita e Njoftimeve për Shtyp si edhe publikimi i njoftimeve që lidhen me veprimtarinë Gjykatës, publikimi i vendimeve gjyqësore të anonimizuara dhe të vlerësuar me interes të lartë publik;
- Në kuadër të zbatimit të objektivit nr. 4 për informimin e publikut mbi tarifat gjyqësore u konceptua video informuese mbi tarifat gjyqësore;
- Në kuadër të përgatitjes së materialeve informuese mbi "Të Drejtat e të Miturve në Konflikt me Ligjin Gjatë Procesit Penal", u konceptua video informuese "Të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin";
- Në kuadër të përgatitjes së materialeve informuese për "Të Drejtat e të Miturve Viktima ose Dëshmitarë të Veprës Penale, u konceptua video informuese "Të drejtat e të miturit viktimë ose dëshmitar i veprës penale";
- Fletë-palosje informuese "IO Dhjetor Dita Ndërkombëtare e Të Drejtave të Njeriut";
- Përshatjet dhe publikuar formularët: Për kërkesë kopje aktesh vendimesh gjyqësore; Për kërkesë për regjistrimin/transmetimin e imazheve filmike të seancës gjyqësore; Mbi zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes; Për deklaratën pëlqimi për përpunimin e të dhënave personale; Format përgjigje mbi refuzimin e formës së kërkuar të informacionit-dokumentacionit; Për përgjigje për kërkesën për informacion; Aplikimi për kërkesë kopje aktesh vendimesh gjyqësore; Formulari tip i ankesës për nëpunësin civil gjyqësor.

Ndërveprimi me Mediat

Nisur nga rëndësia që kanë media, OSHC-të apo grupet e tjera të interesit në përcjelljen e informacionit dhe komunikimin me publikun, Plani Strategjik i Komunikimit synon rritjen e bashkëpunimit dhe fuqizimin e komunikimit me këta aktorë. Meqenëse, si edhe e përmendëm gjeneza e medias ka lindur pikërisht si kërkesë e publikut për të mësuar mbi dhe për pushtetin, si e tillë është jo vetëm një strukturë informuese për dhe mbi pushtetin, por edhe një strukturë plotësuese e kërkesave të publikut për të kontrolluar pushtetin, për ta ruajtur dhe strukturuar këtë formë të një rëndësie të veçantë për pasqyrim, **Gjyqtari i Medias në koordinim me Trupën Gjyqësore të Gjykatës dhe Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, ka mundur të përcjellë mirëinformimin dhe transparencën të proceseve gjyqësore dhe vendimarrjeve.**

I është kushtuar **rëndësi maksimale pritjes së mediave në ambientet e gjykatës gjatë seancave gjyqësore** për të cilat kanë shfaqur interes të ndiqen prej tyre. Gjithashtu, në trajtimin e kërkesave të dërguara në postën elektronike për informacion, intervista, takime, pjesëmarrje në seanca gjyqësore etj., kemi mbajtur standard të njëjtë trajtimi, pa ceduar në asnjë rast në diskriminimin ndërmjet përfaqësuesve të saj, duke regjistruar rigorozitet në zbatim të Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 "Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median **Neni 2/ 3. "Media trajtohet në mënyrë të barabartë, pa diskriminim ndërmjet përfaqësuesve të saj, duke shmangur krijimin ose mbajtjen e kanaleve të komunikimit dhe informuese të privileguara me përfaqësues të caktuar të saj."** Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në kuadër të transparencës dhe krijimit të kushteve për akses transparent, profesional, eficient dhe të shpejtë në kohë, krijoi grupin mediatik në aplikacion telefonik më datë 16.11.2023, pas identifikimit të anëtarëve të saj. Grupit të krijuar për mediat në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, iu është njoftuar zyrtarisht, si në çdo rast gjatë kësaj periudhe ndërveprimi, data dhe ora e seancës gjyqësore për seancat për të cilat kanë shprehur interes, por edhe për seanca gjyqësore apo vendimarrje që janë vlerësuar nga Gjykata me interes të lartë publik. Përfaqësuesve të mediave iu është vendosur në dispozicion **Udhëzuesi Standard** dhe janë informuar për procedurat e aksesimit në seancë gjyqësore në mënyrë të vazhdueshme sipas **Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 "Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median"**, për administrimin e kërkesave për regjistrimin e seancave gjyqësore në kuptim të neneve vijues: 2 Neni 14/1/3/4. "Administrimi i kërkesave për ndjekjen dhe regjistrimin e seancave gjyqësore nga media 1. Seancat gjyqësore mund të regjistrohen dhe transmetohen në media, me kërkesë të mediave ose me nismën e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues. Në çdo rast, regjistrimi dhe transmetimi i seancës, tërësisht ose pjesërisht, bëhet vetëm kur nuk bie ndesh me rregullat e procesit të rregullt ligjor. 3. Seancat gjyqësore, për të cilat përfaqësuesit e medias dhe fotoreporterët kërkojnë imazhe filmike, ndiqen me paraqitjen e kërkesës sipas formularit në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzuesi. Formularët bëhen publikë në faqen e internetit dhe/ose në mënyrë të printuar në mjediset e gjykatës ku bëhet kërkesa. Kërkesa mund të plotësohet edhe online kur ky shërbim ofrohet nga gjykata përkatëse. 4. Kërkesa për pjesëmarrje i paraqitet nëpunësit për marrëdhëniet me publikun dhe median, jo më vonë se njëzet e katër orë para orës së deklaruar për fillimin e seancës gjyqësore." Në zbatim të Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 "Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median", Neni 2/3. "Media trajtohet në mënyrë të barabartë, pa diskriminim ndërmjet përfaqësuesve të saj, duke shmangur krijimin ose mbajtjen e kanaleve të komunikimit dhe informuese të privileguara me përfaqësues të caktuar të saj", Nëpunësi i Marrëdhënieve me Publikun dhe Media kryen komunikim të njëjtë me të gjithë përfaqësuesit e mediave.

Çdo kërkesë e medias për pjesëmarrje në seanca gjyqësore kryhet në përputhje dhe në zbatim të procedurës së përcaktuar dhe në zbatim të Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 "Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median", me paraqitjen e kërkesës me shkrim në Gjykatë, sipas "Formular për Përfaqësuesit e Medias. Kërkesë për Regjistrimin/Transmetimin e Imazheve Filmike të Seancës Gjyqësore", bazuar në vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median", ose në adresën zyrtare manjola.kume@gjykata.gov.al. Nëpunësi për Marrëdhënien me Publikun dhe Median ka detyrimin për të vendosur më pas kërkesën në dispozicion të Trupit Gjyqësor, i cili ka kompetencë kryesisht të shprehet mbi pjesëmarrjen e familjarëve, publikut, medias, sipas kuotave të përcaktuara në Vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median": Neni 13.3 "Pjesëmarrja në seancën gjyqësore. Në rastet kur salla e gjyqësorit nuk ka vende të mjaftueshme për sistemin e të gjithë të interesuarve për të ndjekur seancën, nëpunësi për marrëdhëniet me median dhe publikun, nën kujdesin e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjyqësor, vendos lejimin e pjesëmarrësve në sallë, sipas kësaj radhe: a. subjektet në gjykim; b. familjarët dhe të afërmit; c. përfaqësuesit e medias. Kur numri i familjarëve është më i madh sesa numri i vendeve në sallë, nëpunësi për marrëdhëniet me median dhe publikun, nën kujdesin e gjyqtarit/ kryesuesit të trupit gjyqësor cakton një kuotë vendesh në sallë për familjarët, në mënyrë të tillë që të ruajë edhe një kuotë përfaqësuese për përfaqësuesit e medias. Neni 14.6 Administrimi i kërkesave për ndjekjen dhe regjistrimin e seancave gjyqësore nga media Gjyqtari/kryesuesi i trupit gjyqësor ka të drejtën të: a) lejojë ose ndalojë regjistrimin dhe transmetimin e plotë të seancës; b) lejojë ose ndalojë regjistrimin e pjesshëm të seancës; c) ndalojë transmetimin e pamjeve specifike gjatë një seance dëgjimore, që ishte lejuar më parë të regjistrohej."

Në zbatim të Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 "Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median", Neni 2/3. "Media trajtohet në mënyrë të barabartë, pa diskriminim ndërmjet përfaqësuesve të saj, duke shmangur krijimin ose mbajtjen e kanaleve të komunikimit dhe informuese të privileguara me përfaqësues të caktuar të saj", Nëpunësi i Marrëdhënieve me Publikun dhe Media kryen komunikim të njëjtë me të gjithë përfaqësuesit e mediave.

Çdo kërkesë e medias për pjesëmarrje në seanca gjyqësore kryhet në përputhje dhe në zbatim të procedurës së përcaktuar dhe në zbatim të Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 "Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median", me paraqitjen e kërkesës me shkrim në Gjykatë, sipas "Formular për Përfaqësuesit e Medias. Kërkesë për Regjistrimin/Transmetimin e Imazheve Filmike të Seancës Gjyqësore", bazuar në vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median", ose në adresën zyrtare manjola.kume@gjykata.gov.al. Nëpunësi për Marrëdhënien me Publikun dhe Median ka detyrimin për të vendosur më pas kërkesën në dispozicion të Trupit Gjyqësor, i cili ka kompetencë kryesisht të shprehet mbi pjesëmarrjen e familjarëve, publikut, medias, sipas kuotave të përcaktuara në Vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median": Neni 13.3 "Pjesëmarrja në seancën gjyqësore. Në rastet kur salla e gjyqësorit nuk ka vende të mjaftueshme për sistemin e të gjithë të interesuarve për të ndjekur seancën, nëpunësi për marrëdhëniet me median dhe publikun, nën kujdesin e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjyqësor, vendos lejimin e pjesëmarrësve në sallë, sipas kësaj radhe: a. subjektet në gjykim; b. familjarët dhe të afërmit; c. përfaqësuesit e medias. Kur numri i familjarëve është më i madh sesa numri i vendeve në sallë, nëpunësi për marrëdhëniet me median dhe publikun, nën kujdesin e gjyqtarit/ kryesuesit të trupit gjyqësor cakton një kuotë vendesh në sallë për familjarët, në mënyrë të tillë që të ruajë edhe një kuotë përfaqësuese për përfaqësuesit e medias. Neni 14.6 Administrimi i kërkesave për ndjekjen dhe regjistrimin e seancave gjyqësore nga media Gjyqtari/kryesuesi i trupit gjyqësor ka të drejtën të: a) lejojë ose ndalojë regjistrimin dhe transmetimin e plotë të seancës; b) lejojë ose ndalojë regjistrimin e pjesshëm të seancës; c) ndalojë transmetimin e pamjeve specifike gjatë një seance dëgjimore, që ishte lejuar më parë të regjistrohej."

Ajo që vërehet nga nisja për zbatim e Planit Strategjik të Komunikimit deri në këto momente është se, ndërveprimi dhe trajtimi dinjitoz i përfaqësuesve të medias, mirëpritja dhe sigurimi i aksesit profesional në dhënien e informacionit të monitoruar nga Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka ka rezultuar në dhënien e një feedbacku pozitiv nga përfaqësuesit e mediave të grupit të cilëve u përcillet informacion vetëm në forma zyrtare. **Nuk mund të anashkalojmë pa sjellë në vëmendje edhe faktin se, trasmetimi i saktë, korrekt i informacionit nga media të caktuara është sfidë më vete dhe shpesh është parë e nevojshme, për shkak të trasmetimit jo të saktë informacionit të publikuar, kemi reaguar me Deklarata për Shtyp për të korrigjuar faktet.**

Është për t'u theksuar se, ndërveprimin me mediat ka qenë në rezultate të kënaqshme dhe i mirëpritur prej tyre. Kemi thjeshtuar format e kërkesës për marrje informacioni për seancat gjyqësore, duke kërkuar prej tyre që kërkesat të përcillen në grup dhe jo të veçuara, meqenëse, secili prej tyre është tashmë i identifikuar nga Gjykata se për cilën media reporterët përcjellin informacion.

Kemi ndjekur me interes dhe pa neglizhencë çdo raportim që lidhet me Gjykatën dhe seancat për të cilat kanë raportuar, në kohë reale, duke monitoruar përcjelljen e informacionit që kryhet dhe kur është parë e nevojshme janë përcjellë korrektime të fakteve. Koordinatori me udhëzim të Gjyqtarit të Medias z. Ardit Kuka, ka ndjekur çdo seancë gjyqësore në të cilën kanë qenë prezentë media duke siguruar akomodimin e tyre në seancë dhe duke ndjekur raportimet që bëhen për seancën, në mënyrë që të kemi mundësinë e një kontrolli real dhe të saktë të raportimeve që kryejnë në lidhje me informacionet që përcjell media për Gjykatën nga një seancë gjyqësore. I gjithë procesi ndiqet në mënyrë aktive nga Gjyqtari i Medias duke u informuar nga Koordinatori, përgjatë dhe pas procesit, në lidhje me publikimet dhe raportimet e kryera nga mediat në seancë. Në çdo rast, kur janë paraqitur problematika të caktuara janë informuar dhe ZV/Kryetarët e Gjykatës sipas periudhave respektive të ushtrimit të funksionit të tyre për të patur një vlerësim të plotë dhe profesional të situatave për reagim publik. Kontrollonhet çdo ditë shtypi i ditës në lidhje me titujt e gazetave që lidhen me Gjykatën duke i referuar për vlerësim titujt Gjyqtarit të Medias.

Duke vlerësuar se, Deklarata për Shtyp, Njoftimet për Shtyp, Njoftimet Informuese janë një instrument për shpërndarjen e informacioneve në mënyrë të saktë, është ndërtuar tashmë tradita për të publikuar shpesh edhe Deklarata për Shtyp sipas formateve të përcaktuara në Planin Strategjik të Komunikimit, për çështjet që kanë patur interes të lartë publik, me miratimin dhe respektimin e dakordësisë për publikim të tyre nga Gjyqtarët e çështjeve, Gjyqtari i Medias, si edhe ZV/Kryetarët respektivë të Gjykatës, duke i kushtuar rëndësi faktit që përcimi i mesazhit në deklarata të jetë korrekt, i saktë dhe në përputhje me vlerësimin për publikim të Gjyqtarit të çështjes për qartësimin e situatave të caktuara kur ka lind nevoja për qartësim të situatave të keqinformuara nga media drejt opinionit publik.

Mbajtja e kontakteve me përfaqësues lokal të medias për dhënien e informacionit me kërkesë të tyre për çështje për të cilat kanë shprehur interes nëpërmjet kërkesave të drejtuara në postën elektronike të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Median.

Intervista në mediat kombëtare

Janë realizuar 5 (pesë) intervista në Media Kombëtare nga gjyqtarë të ndryshëm të Gjykatës për promovimin e punës së gjykatës si:

Intervista në mediat kombëtare

PLANI VEPRIMIT



Gjyqtari z. Ardit Kuka për Vizion Plus



Gjyqtari z. Artur Prenga për Top Media



Gjyqtari z. Elis Dine për BIRN



Gjyqtare znj. Suela Lika për RTSH

Intervista e Gjyqtarit **z. Ardit Kuka** për Vizion Plus dhe **Abc News** më datë 31.01.2024 për kërkesat me objekt nenin 130/a "Dhuna në familje" dhe Ligj Nr.9669, neni 10 dhe 13, "Urdhëra mbrojtje".

Intervista e Gjyqtarit **z. Artur Prenga** për **Top Channel** më datë 11.06.2024 në lidhje me objekt "Statistika për të Dënuar të Mitur Vitet 2022-2023".

Intervista e Gjyqtarit **z. Elis Dine** më datë 15.11.2024 për **BIRN** dhe **ElbasaniOn** me objekt "Veprat penale që lidhen me krimin kibernetik, dhunën në familje".

Intervista e Gjyqtare **znj. Suela Lika**, për **RTSH** me objekt "Statistika për llojet e veprave penale, veprat penale që lidhen me shitjen dhe prodhimin e lëndëve narkotike. Strategjitë dhe masat e marra prej Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për uljen e numrit të dosjeve për shqyrtim të mbartura dhe të ardhura të reja. Marrëdhëniet e gjykatës me median në kuadër të garantimit të aksesit të medias në gjykatë, mirëinformimit dhe transparencës publike."



Gjyqtari z. Ardit Kuka për Inside Story

Me ftesë të **Inside Story**, prononcimi i Gjyqtarit të Medias në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Ardit Kuka**, në Dokumentarin Investigativ për "Bandat Kriminale të Vitit 1997-të në qytetin e Elbasanit".

Tryeza Takimi me Mediat



Tryeza takimit me media 14.11.2023

Në kuadër të zbatimit të objektivave të Planit Strategjik të Komunikimit, me synim forcimin e bashkë-veprimit me përfaqësues të mediave dhe ndërtimit të një komunikimi proaktiv mes gjykatës dhe mediave, më datë **14.11.2023** Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit

të Përgjithshëm Elbasan me kërkesë të Gjyqtarit të Medias **z. Ardit Kuka**, organizoi një tryezë të përbashkët diskutimi me përfaqësues të medias për konsultimin e "Problematikave të medias në raport me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan".



Tryeza takimit me media 25.11.2024

Më datë **25.11.2024** në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan u zhvillua seminari me përfaqësues të medias. Prologu i takimit nisi me fjalën e Zv/ Kryetarit **z. Artur Prenga**, i cili vlerësoi impenjimin aktiv të përfaqësuesve të medias.

Gjyqtari i Medias **z. Ardit Kuka** referoi në këtë takim për:

- Solemnitetin e gjykimit, referuar Vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë Nr.238/1/B, Datë 24.12.2008.
- Rregullat e askesit në seancë gjyqësore nga përfaqësuesit e medias.

Aktivite

PLANI VEPRIMIT

Në kuadër të realizimit të kërkesës së Planit Strategjik të Komunikimit për realizimin e **aktivitete informuese, ndërgjegjëse, edukative** në bashkëpunim me OSHC-të, Fakultetet, Institucionet Arsimore dhe grupe të tjera interesi, janë zhvilluar disa aktivitete informuese, edukative dhe ndërgjegjëse me nxënës të Shkollave të Mesme, Forume Rinore dhe studentë të Fakulteteve të Drejtësisë (gjyqe imituese), përmendim në vijim realizimin e disa prej tyre:

1. Aktiviteti i Datës 24.03.2023. Tematika: Orët e Hapura në Gjykatë “Procese Gjyqësore Penale dhe Civile me Dyer të Hapura”. Zv/Kryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Znj. Matilda Fetau, në bashkëpunim me përfaqësues të Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, miratoi pritjen e studentëve në sallat ku zhvilloheshin seanca gjyqësore. Nxënësit u mirëpritën nga Zv.Kryetarja Znj. Matilda Fetau dhe Gjyqtari Z. Elis Dine.

2. Aktiviteti i Datës 19.05.2023. Tematika: “Zhvillimi i Seancave gjyqësore nga Magjistratët e së Ardhmes”, aktiviteti u zhvillua me nxënës të Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Dhaskal Todri”. Aktivitetit u asistua nga gjyqtari Z. Elton Frashëri.

3. Aktiviteti i Datës 07.06.2023. Tematika: “Orët e Hapura në Gjykatë”. Aktiviteti u organizua me nxënës të Shkollës së Mesme Jopublike Medrese “Liria”, si pjesë e programit të kurrikulës mësimore të institucionit mësimor, me qëllim njohjen më nga afër të veprimtarisë së Gjykatës dhe shërbimeve që u ofrohen publikut. Nxënësit u mirëpritën në sallat ku zhvillonin seanca gjyqarë: Z. Elis Dine, Z. Elton Frashëri, Znj. Idush Maliqi, Znj. Megi Strakosha.

4. Aktiviteti i Datës 14.06.2023. Tematika: Ese me temë “Të drejtat e fëmijëve”. Aktiviteti u zhvillua në dy faza, në fazën e parë u ftuan me shpresë disa nga shkollat e mesme të qytetit të Elbasanit për pjesëmarrje në krijimin e esesë me temë “Të drejtat e fëmijëve”, frymëzuar nga esesa “Letër nga burgu i Birmingham” e Marthin Luther King Jr. Faza e dytë e aktivitetit u realizua në datë 02.06.2023, për të mundësuar certifikimin e të gjithë pjesëmarrësve në aktivitetin krijues.

5. Aktiviteti i Datës 20.11.2023. Tematika: “20 Nëntor Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve”. Ky aktivitet u realizua në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Fëmijëve”, e cila është shënuar në kalendar që prej dhjetorit të vitit 1954, ku Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka rekomanduar të gjitha shtetet të kenë një ditë të institucionalizuar që i përket “Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Fëmijëve”. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në kujtesë të kësaj dite, organizoi një tryezë takimi me nxënës të shkollës “Sulë Harri”, të cilët u mirëpritën nga Zv/ Kryetarja znj. Matilda Fetau.

6. Aktiviteti i Datës 22.12.2023. Tematika: “Gjyq Imitues, 75 Vjetori i Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut”. Ky aktivitet u planifikua në kuadër të 75 vjetorit të “Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut”, me nxënës të Shkollës së Mesme Jopublike Medrese “Liria”. Në pjesën e parë të takimit Zv/Kryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Znj. Matilda Fetau, prezantoi dhe vendosi në dispozicion për nxënësit Deklaratën e të Drejtave të Njeriut. Në pjesën e dytë të aktivitetit u zhvillua seanca gjyqësore e përgatitur prej nxënësve me shumë duke performuar një gjyq imitues të ndërtuar me të gjithë komponentët përbërës të një seance gjyqësore. Nxënësit pjesëmarrës u certifikuan.

7. Aktiviteti i Datës 08.05.2025. Në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë 10 maj, u realizua aktiviteti për “Javën e Drejtësisë” në të cilën Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka dhe Gjyqtari z. Gjergji Baçi, zhvilluan takime me nxënës, mësues dhe drejtues të Gjimnazit “Dhaskal Todri” Elbasan dhe Gjimnazit “Ibrahim Muça” Librazhd. Në kuadër të kësaj dite janë publikuar 47 esetë e punuara paraprakisht nga nxënësit me temë “Inkluzioni dhe të Drejtat e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar”.

8. Aktiviteti i Datës 03.12.2025. Në kujtesë të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga, Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka dhe Gjyqtarja zn. Suela Lika, mirëpritën drejtues, mësues dhe nxënës të shkollave të mesme: Dhaskal Todri, Medrese Lira dhe Ahmet Dakli të qytetit të Elbasanit, në një takim i cili u realizua në vazhden e aktiviteteve me nxënës të shkollave të mesme, të cilët u angazhuan në asistimin e nxënësve për krijimin e esesë me tematikë “Inkluzioni dhe të Drejtat e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar”, të krijuara nga nxënësit në kuadër të Javës së Drejtësisë të cilët u certifikuan në lidhje me krijimtarinë e tyre.

9. Aktiviteti i Datës 10.12.2024. Zv/ Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga, mirëpriti Këshillin Rinor të Bashkisë Elbasan, në një takim në kuadër të afrimit të komunitetit me gjykatat dhe njohjes së të miturve me Institucionet e Drejtësisë, përmes organizimit të aktiviteteve publike në zbatim të Planit Strategjik të Komunikimit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për ti dhënë mundësi anëtarëve të Këshillit Rinor të Bashkisë Elbasan të njihen me veprimtarinë, ambientet dhe funksionet e gjykatës.

10. Aktiviteti i Datës 11.12.2024. Me studentë të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” vizituam klasat e 9-ta të shkollës “Naim Frashëri” Elbasan. Projekti lindi si ide nga frekuentimi i “Orëve të Hapura në Gjykatë”, ku studentë të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, të cilët ndjekin vazhdimisht seanca me detyrë të hapura të seksionit penal dhe civil, pranuan ftesën për angazhim në projekte të tjera të Gjykatës në lidhje me informimin e Kodit të Drejtësisë Penale Për të Miturit në Konflikt me Ligjin, si edhe informimin e kuadrit ligjor për të Drejtat e Fëmijëve. Projekt- ideja për zhvillimin e një sërë aktiviteteve me objekt “Këshillim karriere, sensibilizim dhe njohje e të miturve me kuadrin ligjor të drejtësisë për të mitur” u mbështet dhe u formalizua me asistimin dhe qëllimin për të patur një shtrirje më të gjërë në disa institucione edhe jashtë Gjykatës nga Zv/ Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga dhe Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka të cilët udhëzojnë dhe asistojnë formalizimin e projekteve nga ana profesionale dhe ligjore, projekte të cilat Zv/ Kryetari i Gjykatës z. Artur Prenga, synon të rriten në nivele profesionale bashkëpunimi me finalizimin e lidhjes së Marrëveshjeve me Institucionet Arsimore përkatëse. Ky projekt nisi me shkollën 9-vjeçare “Naim Frashëri”.

11. Aktiviteti i Datës 28.03.2025. Me studentë të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” dhe shkollës së mesme “Medrese Liria” Elbasan. Takimi u realizua në kuadër të projektit të nisur në Dhjetor 2024, me synimin për zhvillimin e aktiviteteve me objekt “Këshillim karriere, sensibilizim dhe njohje e të miturve me kuadrin ligjor të drejtësisë për të mitur”.



Tryeza takimi

PLANI VEPRIMIT

1.Takimi i datës 09.01.2024. Në kuadër të ndëveprimit ndërinstitucional më datë 09.01.2024 me ftesë të Shkollës së Magjistraturës u mirëprit dhe u organizua nga Gjykata takimi me tematikë "Efektiviteti i Programve të Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurororët nga Shkolla e Magjistraturës.



2.Takimi i datës 07.03.2024. Në kuadër të bashkëveprimit ndërinstitucional me kërkesë të ekspertit të lartë ligjor z. Arben Lila në projektin EU4Justice- projekt i Bashkimit European në mbështetje të institucioneve të pavarura të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mirëpritëm organizimin e takimit me tematikë "Zbatimin i Hartës së Re Gjyqësore".



3.Takimi i datës 25.04.2024. Zv. Kryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan znj. Matilda Fetau mirëpriti në një tryezë takimi sëbashku me Trupën Gjyqësore të Gjykatës, Drejtuesin e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan z. Ilir Proda, Shefin e Komisarariatit të Policisë Elbasan z. Roven Zeka, Shefin e Komisarariatit Peqin z. Pellumb Kovashica, Shefin e Komisarariatit Librazhd z. Petrit Hala, Shefin e Komisarariatit Gramsh z. Krenar Guçe, Shefin e Komisarariatit Cërrik z. Islam Haka, Zv. Drejtorin për Sigurinë Publike z. Besnik Kongjonaj. Objekti diskutimit të tryezës së takimit ishte "Rritja e ndëveprimit institucional në funksion të mbarrëvajtjes së proceseve gjyqësore". Në sajë të këtij takimi, u bë e mundur ndëveprimi mes institucioneve dhe u vendosën pikat e kontaktit të adresave zyrtare elektronike të Komisariateve të Policisë me adresën zyrtare të Gjykatës duke siguruar kështu efikasitet dhe ndëveprim të shpejtë në përcjelljen e shkresave me urdhër të gjyqtarëve.



4.Takimi i datës 21.06.2024. Zv/Kryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan znj. Matilda Fetau mirëpriti në një tryezë takimi Shefin e Policisë së Burgjeve z.Vladimir Skenderi dhe Drejtorin e "Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan" z. Altin Ago. Tryeza e takimit u relaizua me synim "Rritjen e ndëveprimit institucional në funksion të mbarrëvajtjes së proceseve gjyqësore". Takimi u relaizuar me kërkesë të Drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan z. Altin Ago. Në këtë takim u diskutua për mbarrëvajtjen e procesit të punës në lidhje me menaxhimin e veshtirësive të mundshme për shoqërimin e të paraburgosurve në proceset gjyqësore, si edhe problematikat e hasura mbi Urdhërat për Shoqërimin e të Burgosurve në Gjykatë.



5.Takimi i datës 25.06.2024. Me ftesë të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit u mbajt seminari me Trupën Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në mbështetje të Indikatorit 7-të të SBS-së së "#BE për Reformën në Drejtësi" dhe Strategjitë Ndërsëktoriale të Drejtësisë dhe Planit të Veprimit për vitet 2021-2025. Tematika e seminarit ishte "Sistemi i Ndërmjetësimit dhe Mekanizmi i Referimit të Çështjeve në Ndërmjetësim" dhe modeli i formularit referues". Në takim ishin të ftuar: Zv/Ministri i Drejtësisë z. Tedi Dobi; Gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar z. F. Iorjan Kalaja; Dretjori i Përgjithshëm i Profesioneve të Lira dhe Ekstradimeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë znj. Flora Dedgjonaj. Kjo tryezë takimi u realizua me ftesë të Kryetares së Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit znj. Drita Avdyli në kuadër të Projektit Pilot të implementimit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve me Ndërmjetësim në të cilën është përzgjedhur për pilotim të projektit edhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.



6.Takimi i datës 02.12.2024. Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga mirëpriti në një tryezë takimi Drejtorin e Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Elbasan z. Gazidedja, Specialistët: znj. Irena Gorrica dhe z. Shukri Marku. Takimi u realizua me synim "Rritjen e ndëveprimit institucional në funksion të mbarrëvajtjes së proceseve gjyqësore dhe standardizimin e praktikave të njësuara, inkurajimi për zbatimin e dënimeve alternative", vijimin e një bashkëpunimi eficient ndërmjet institucioneve për paraqitjen e raporteve para gjykatës, për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore në zbatim të konfidencialitetit, besueshmërisë dhe integritetit.



7.Takimi i datës 12.12.2024. Zv/ Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga, mirëpriti avokatët e Dhomës Vendore të Avokatisë Elbasan, për të dëgjuar shqetësimet e tyre në raport me Gjykatën, nëpërmjet adresimit dhe referimin të saktë të problematikave të hasura, në kuadër të forcimit të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës dhe grupeve të interesit.



8.Takimi i datës 16.12.2024. Me ftesë të Zv/ Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga, u zhvillua takimi me Kryetarët e Bashkive të Qarkut të Elbasanit. Në takim ishin të ftuar: Kryetari i Bashkisë Elbasan z. Gledjan Llatja; Kryetari i Bashkisë Cërrik z. Andis Salla; Kryetari i Bashkisë Librazhd z. Mariglen Disha; Nënkryetari i Bashkisë Elbasan z. Asim Sula; Përgjegjëse e Sektorit të Informimit në Bashkinë Elbasan znj. Leda Sejdi. Takimi u zhvillua në kuadër të "Rritjes së Ndëveprimit Institucional ndërmjet Bashkive të Qarkut të Elbasanit dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbi standardizimin e procedurave dhe krijimin e pikave të kontaktit për ndëveprimet proceduriale mes Gjykatës dhe Zyrave të Shërbimeve Sociale në Bashkitë e Qarkut, kryesisht me Sektorin e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore, pjesë e strukturave të Organikave të Bashkive". Në vijim, në funksion të këtij takimi, do të ngihen strukturat e posaçme me grupet e punës mes Gjykatës dhe Bashkisë Elbasan, të cilët do të hartojnë procedurat konktete për vendosjen në praktikë të këtij Projekti-Ndërinstitucional, për realizimin e trajnimeve të nëpunësve të administratës së Bashkive të Qarkut Elbasan, që do të specializohen për çështjet e drejtësisë për të miturit.



9.Takim i datës 06.02.2025. Takim i programuar në Dhjetor të Vitit 2024. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, u zhvillua takimi për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit (Internship) "Për zhvillimin e praktikave profesionale" ndërmjet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Në takim ishin të ftuar: Rektorja e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" znj. Elvira Fetau, Dekani i Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" z. Shpetim Cerri. Të ftuarit u mirëpritën nga Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga dhe Gjyqtari i Seksionit Penal z. Elis Dine.



10. Takimi i datës 12.02.2025. Takim i Zv/ Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga me Ambasadorin e Republikës Federale të Austrisë në Shqipëri znj. Monika Zach dhe përfaqësues të projektit "Mbështetje për Drejtësinë e Aksesueshme për Gratë dhe Burrat në Shqipëri" UNDP (United Nations Development Programme) dhe ADC (Austrian Development Cooperation). Të ftuarit u mirëpritën nga Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga dhe Gjyqtarja e Seksionit Penal znj. Aurora Alimadhi.



Në përfundim, në mbyllje të periudhës kalendarike të afatit për realizim të objektivave të Planit Strategjik të Komunikimit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për zbatim nga gjykatatat, nga detyrata e përcaktuara në praktikën e Planit të Veprimit **nuk janë realizuar**:

- Udhëzues i printuar me informacion mbi Gjykatën 1000 kopje.
- Vendosija e materialeve të printuara për promovim të Logos dhe Kodit Qr që përmban informacion mbi faqen e internetit/rrjeteve sociale, adresat e Gjykatës.
- Nuk janë publikuar në faqe zyrtare intervistat e dhëna për mediat nga Gjyqatarët e Gjykatës, të cilat janë publikuar vetëm në rrjetin social Facebook.
- Nuk është realizuar publikimi i një video informuese mbi riorganizimin e gjyqësorit, duke e shoqëruar me audio dhe gjuhën e shenjave.
- Përgatitja dhe publikimi online i një video për shërbimet e ofruara nga Gjykata e shoqëruar me gjuhën e shenjave, si edhe printimi i fletëpalosjes në të paktën 2000 kopje; është publikuar vetëm format broshure online, pjesa tjetër mbetet për realizim.

Informacion i plotë mbi zhvillimet e aktiviteteve, tryezave të takimit dhe jo vetëm, gjendet në përmbajtje të Revistave Nr. 1 dhe Nr. 2 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të publikuara në faqen zyrtare www.gjykata.gov.al.

Faleminderit

Përgatiti relacionin Manjola Kume